

**AKTI I THEMELIMIT**  
**DHE**  
**STATUTI**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**GREEK MARKET SH.P.K.**

*KAPITULLI I*

*EMRI, FORMA E SHOQËRISE, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA*

Sot, në datën 27.03.2024, ne të poshtëshënuarit:

1. **Aleksander Allkaj** i datëlindjes: 13.05.1985, Lindur në Vlorë, dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal:I50513022D'
2. **Foti Qesari**, i datëlindjes 14.05.1984, Lindur në Vlore dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal: I40514114E
3. **Eliverta Allushi** i datëlindjes 26.11.1982, Lindur në Vlore dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal: I261226032I

me cilësinë e "ortakëve themelues" deklarojmë se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007" Për Regjistrimin e Biznesit ", i ndryshuar, dhe legjislacionit në fuqi në lidhje me Shoqëritë Tregëtare, dhe dispozitat e këtij statute dhe akt themelimi, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, "GREEK MARKET" shpk.


*KAPITULLI I*

*EMRI, FORMA LIGJORE E SHOQËRISË, SELLA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA*

**Neni 1**

**THEMELIMI**

1. Emri i shoqërisë është Greek Market sh.p.k. (më tej referuar si "Shoqëria");
2. Shoqëria është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
3. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligj.



4. Aktiviteti i Shoqërisë do të ushtrohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave të këtij Akti Themelimi dhe Statuti.

#### Neni 2

#### SELIA

1. Selia e ushtrimit të aktivitetit tregtar të Shoqërisë është në adresën:  
"Tiranë, Mëzes, Autostrada TB-DR Km 5 Tiranë, Shqipëri".  
*Godina ZDS*

2. Shoqëria mund të themelojë degë, zyra përfaqësimi, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me ligjet në fuqi dhe dispozitave të këtij Akti Themelimi dhe Statuti.

#### Neni 3

#### OBJEKTI I SHOQËRISË

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë do të jetë:

1. Çdo aktivitet i shitjes me shumicë dhe pakice, drejtimi, administrimi dhe shfrytezimi i supermarketeve dhe hipermarketeve, shitja me pakice e produkteve ushqimore dhe jo- ushqimore, prodhimi i produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore dhe transportimi dhe ruajtja e produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore, import të produkteve që do të shiten me shumicë dhe pakicë, si dhe çdo veprimtari tjetër e ligjshme.

2. Si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë e që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi.

#### Neni 4

#### KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të themelohet për një kohëzgjatje (afat) të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### KAPITULLI II

#### KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT-PJESËT E KAPITALIT

#### Neni 5

#### KAPITALI THEMELTAR DHE ORTAKU I VETËM

1. Kapitali i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 3 kuotë të zotëruar në masën si më poshtë vijon:



- **Aleksander Allkaj** zotëron 1 (një) kuotë në vlerën 40.000 (dyzet mijë) lekë, e cila përbën 40 % të kapitalit të shoqërisë;
  - **Foti Qesari**, zotëron 1 (një) kuotë në vlerën 40.000 (dyzet mijë) lekë, e cila përbën 40 % të kapitalit të shoqërisë;
  - **Eliverta Allushi** zotëron 1 (një) kuotë në vlerën 20.000 (njëzet mijë) lekë, e cila përbën 20 % të kapitalit të shoqërisë;
2. Kuotat e Ortakëve të Shoqërisë janë lirisht e transferueshme sipas legjislacionit tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
3. Kapitali fillestar i Shoqërosë zotërohet nga Ortakët e Shoqërisë;
4. Ortakët e Shoqërisë përgjigjen për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të saj.

#### **Neni 6**

#### **TRANSFERIMI I KAPITALIT**

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".
3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

#### *KAPITULLI III*

#### *ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË*

#### **Neni 7**




## ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme, ligjërisht e thirrur dhe rregullisht e mbledhur është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e saj, të marra në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitave të këtij Akti Themelimi dhe Statuti, janë të detyrueshme për t'u ndjekur dhe zbatuar;

2. Asambleja e Përgjithshme ka këto funksione:

- Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikqyr zbatimin e tyre nga Administratori duke përfshirë raportimet financiare;
- Emëron dhe shkarkon Administratorin(-ët);
- Emëron dhe shkarkon ekspertin(-ët) kontabël dhe/ose likuiduesin(-ët) e Shoqërisë;
- Përcakton pagat dhe shpërblimet për Administratorin(-ët), ekspertët(-ët) kontabël dhe likuiduesit(-ët) e Shoqërisë;
- Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurise së veprimtarisë të përgatitura nga Administratori;
- Merr vendim për ndryshimet e këtij Akti Themelimi dhe Statuti të Shoqërisë;
- Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve, dividendëve;
- Merr vendim për ristrukturimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
- Merr vendim për pjestimin e kuotave;
- Merr vendim për hapjen e degëve dhe/ose zyrave të përfaqësimit të Shoqërisë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë;
- Merr vendim për themelimin e shoqërive të reja Joint Venture ose aleanca që lidhen me shitjen blerjen, pjesëmarrjen dhe investimin në projekte ekzistuese dhe të reja;
- Vendos për dhënien dhe marrjen e fondeve hua ose paradhënie nga ortakët dhe administratorët për nevoja personale dhe për financim biznesi;
- Miraton kërkesat e reja dhe vendos për rinovimin e kërkesave ekzistuese për financim;
- Vendos për bllokimin dhe lënien peng të pasurive të paluajtshme pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;



- Vendos për emërimin dhe shkarkimin e Drejtorëve të Financës dhe zëvendësve të Administratorit;
- Vendos për prishjen/likuidimin e Shoqërisë;
- Miraton buxhetin vjetor të shoqërisë;
- Miraton investimet dhe shpenzimet të cilat nuk janë parashikuar në buxhetin vjetor;
- Vendos për blerjen e pasurive të paluajtshme;
- Miraton planin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë;
- Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuara nga ligji.

## Neni 8

### MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik do të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Adminsitatori ose nga një a më shumë ortakë që përfaqesojnë të pakten 5% te kapitalit të Shoqërisë;
3. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
4. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.
5. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 3 dhe 4 të këtij neni, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
6. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 3 të këtij neni, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Me përjashtim të rasteve kur

parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera renditura më sipër, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

7. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

## Neni 9

### REGJISTRI I VENDIMEVE

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme duhet të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen. Regjistri i Vendimeve duhet të mbahet nga Administratori dhe çdo regjistrim duhet nënshkruar nga Administratori.

## Neni 10


### ADMINISTRATORI

#### 10.1 Administratori dhe mandati përkatës

1. Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Administratori i Shoqërisë është Z. **Foti Qesari**, i datëlindjes 14.05.1984, Lindur në Vlore dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal: I40514114E, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
3. Mandati i Administratorit është 5 (pesë) vjet, i rinovueshëm dhe zgjatet deri në vendimin pasardhës të Asamblesë së Përgjithshme, që vendos për revokimin, rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit(eve) të ri.

#### 10.2 Të drejtat e Administratorit

1. Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori.
2. Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
  - Administron veprimtarinë e Shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
  - Përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me çdo palë të tretë.
  - Merr masa për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumentave.



- Përgatit dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore dhe bilanci e konsoliduara, përgatit raportin e ecurisë dhe ia dorëzon këto të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve Asamblesë së Përgjithshme për miratim.

- Krijon sistemin e paralajmërimit në lidhje me rrethana, që kërcënojnë veprimtarinë e Shoqërisë.

- Dorëzon në Qendrën Kombëtare të Biznesit dokumentat dhe të dhënat e përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

- Raporton Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përmbushjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për ecurinë e Shoqërisë.

- Kryen çdo detyrë tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky Statut.

3. Administratori mund të autorizojë nëpërmjet një prokure një person të tretë për të përfaqësuar Shoqërinë dhe për të nënshkruar çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë.

4. Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve të parashikuara nga dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 11**

#### **EKSPERTI(ËT) KONTABËL TË JASHTËM**

1. Pasqyrat financiare të Shoqërisë do të auditohen të paktën një herë në vit nga një, apo më shumë, ekspert kontabël të jashtëm.
2. Me marrjen në dorëzim të raportit përkatës të auditimit, Administratori i Shoqërisë do të marrë të gjitha masat përkatëse për ndreqjen e parregullësive të konstatuara nga raporti.

#### *KAPITULLI IV*

#### *VITI FINANCIAR - SHPËRNDARJA E FITIMEVE*


#### **Neni 12**

#### **VITI FINANCIAR**

1. Viti financiar fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 13**

#### **SHPËRNDARJA E FITIMEVE**



Pas miratimit të pasqyrave financiare vjetore, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të fitimit, nëse ka.

#### KAPITULLI V

#### PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

#### Neni 14

#### PRISHJA DHE LIKUIDIMI

1. Në rast se Asambleja e Përgjithshme vendos për prishjen e Shoqërisë do të emërohen një ose më shumë likuidues.
2. Eksperti kontabël i Shoqërisë do të emërohet nga Asambleja e Përgjithshme nëse emërimi i tij është i detyrueshëm në bazë të legjislacionit në fuqi. Mandati i Ekspertit kontabël është i rinovueshëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### KAPITULLI VI

#### DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

#### Neni 15

#### LIGJI I ZBATUESHËM

Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen nga ky Akt Themelimi dhe Statut i Shoqërisë do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.

#### Neni 16


#### TË NDRYSHME

Ky Akt Themelimi dhe Statut i Shoqërisë me Përgjegjesi të Kufizuar “Greek Market” Sh.p.k. përpilohet në kater (4) kopje në gjuhën shqipe dhe nënshkruhen rregullisht nga Ortakët e Shoqërisë, sot, më 27.03.2024 në Tiranë.

#### ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

#### GREEK MARKET SH.P.K.

Aleksandër Allkaj

Aleksandër Allkaj  


Foti Qesari

Foti Qesari  


Eliverta Allushi

Eliverta Allushi  
